



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

INTELIGJENCA EMOCIONALE SI TRAJTESË PSIKOMETRIKE NË ZHVILLIMIN E DISIPLINËS SË PSIKOLOGJISË

Manuela Varoshi*, Silva Ibrahimii**, Eglantina Dervishi***

*Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

**Departamenti i Psikologjisë “Albanian University”, Tiranë

***Departamenti Psikologji-Pedagogji, Fakulteti Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

Adresë kontakti: silva.ibrahimi@yahoo.it

Përmbledhje

Objektivi: Objektivi i kësaj trajtese është të eksplorojë bazat teorike dhe implementimin e Inteligjencës Emocionale (EI) në disiplinën e Psikologjisë duke u fokusuar në dy linja kryesore. Së pari, synohet të jepet një panoramë në kërkimin metanalitik sipas kërkimeve inovative në bazë të modelit Mayor dhe Slavery (MCET). Së dyti, do të fokusohemi në analizën e indeksit dhe të vlerave të implemetuara si në arrijtet akademike e ndërpersonale, ashtu edhe në përshtatshmërisë personale dhe shoqërore të grumbulluara përmes testit MCET në studentët e ciklit të dytë, Master i Shkencave në Edukim dhe Institucionit në fushën e Psikologjisë.

Metoda: Metoda e administruar në këtë trajtesë është e metodologjisë mikse, e realizuar nëpërmjet mbledhjes së të dhënave studimore metanalitike sipas modelit Mayor-Slavery dhe koncepteve empirike të mbledhura në kontekst. Inteligjenca Emocionale (EI) si një formë teorike është zhvilluar fillimisht nga psikologët Amerikanë (1). Ky instrument ka nxitur specialistët për të thelluar kërkimet shkencore mbi EI si një dinamikë e përshtatjes emocionale, mirëqenies psikologjike, dinamikave të personalitetit, marrëdhënieve ndërpersonale dhe suksesit në jetë (2).

Rezultatet: Kjo trajtesë e realizuar përmes metodologjisë mikse na paraqet një pikëpamje bashkëkohore të Inteligjencës Emocionale. Administrimi dhe implementimi i testit MCET shfaq të dhëna të një korrelacioni të fortë mes komponentëve kryesore të studimit dhe kontekstit të përgjithshëm psikologjik.

Konkluzione: Në përfundim të kësaj trajtese, ne do të artikulojmë disa gjetje dhe rekomandime të nxjerra nga ky studim paraprak për zhvillimin dhe implementimin e EI në fushën e psikologjisë dhe të edukimit në mjedisin shqiptar.

Fjalë çelës: Inteligjencë Emocionale, Përshtatshmëri Psikologjike, Arritje Akademike, Mirëqenie Psikologjike.

EMOTIONAL INTELLIGENCE AS A PSYCHOMETRIC APPROACH FOR THE DEVELOPMENT OF THE DISCIPLINE OF PSYCHOLOGY

Abstract

Objective: The objective of this article is to explore the theoretical bases and implement Emotional Intelligence (EI) in the discipline of Psychology focusing on two main lines. First, it is aimed to be given an overview on metanalytic research as by innovative researching in the Mayor and Slavery model (MCET). Second, we will focus on the analysis of the indexes and values implemented either on academic and interpersonal achievements or in the personal and social adjustment collected through the MCET test in second cycle students, Master of Science in Education and Institutional Psychology field.

Method: The method conducted in the study was a mixed one through a collection of metanalytical researching data of the Mayor-Slavery model and empirical concepts collected in context. Emotional intelligence (EI) as a theoretical form was originally developed by American psychologists (1). This instrument has motivated experts to deepen scientific research on EI as a dynamic of emotional adjustment, psychological welfare, interpersonal dynamics and personality relations and success in life (2).

Results: The present article is conducted through mixed methodology. It represents a contemporary view of Emotional Intelligence. The administration and implementation of MCET revealed a significant correlation between the major components of the study and the overall psychological context.

Conclusions: At the end of this article we have articulated some findings and recommendations of the feasibility study for the development and implementation of EI in the field of Psychology and Education in the Albanian environment.

Keywords: Emotional Intelligence, Psychological Adjustment, Academic Achievement, Psychological Welfare.

Hyrje

Ndërtimi i inteligjencës emocionale (EI) si një formë teorike sistematike është zhvilluar fillimisht nga psikologët amerikanë (3), e më tej në specialistët në të gjithë botën (4). Kërkimet shkencore mbi marrëdhëniet mes inteligjencës emocionale (EI) dhe mirëqenies psikologjike kanë treguar një variancë të lartë pozitive. Ekspertë të shquar në fushën e Inteligjencës Emocionale kanë argumentuar se elementë të rëndësishëm psikologjike si empatia, vetëbesimi dhe vetëdija janë thelbësore për një përshtatshmëri të lartë mes individit dhe mjedisit rrethues (5). Qyshse koncepti i EI u popullarizua më 1995, kërkime të panumërta kanë shoqëruar hulumtimet e korrelancës mes EI dhe rezultateve pozitive (output). Vëmendje e madhe i është kushtuar lidhjes mes suksesit në arsimim dhe aftësive socio-emocionale nga grupet e autorëve, që kanë sugjeruar se inteligjenca emocionale (EI) është më e rëndësishme në parashikimin e suksesit akademik sesa Koeficienti i Inteligjencës (KI/IQ) (6). Në kërkimet e tyre, autorë të tjerë kanë treguar se lënia e hershme e shkollës 9-vjeçare, për shembull, është në korrelacion me nivelet e larta të papunësisë, fitimet më të ulëta dhe shtimin e problemeve të shëndetit (7).

Kërkimet që përshtatin dhe implementojnë EI si element mësim-marrës dhe të aplikuar në

kurrikulat shkollore, vazhdojnë të paraqesin interes të veçantë në literaturën e shkencave të edukimit. EI konceptohet si një entitet në komponentin e vet të *rregullatorit (dispozitës)*, duke përfshirë karakteristikat e personalitetit, ontologjike (thelbësore) dhe fenomenologjike (të marra me përvojën), të komponentit të *rritjes perceptivë*, të shfaqura si karakteristikat e veprimeve bihejviorale dhe emocionet bashkëshoqëruese, që pasqyrojnë tipe të ndryshme të rregullimit të vetëdijshme të sjelljes dhe niveli i EI që mbart vetë individin. Operacionalizimi i EI bazohet në depistimin e tipeve të ndryshme të veprimeve bihejviorale: (a) niveli impulsiv, të kushtëzuar nga situata dhe me fillim nga niveli sensoro-perceptiv (me shfaqje të dominancës së “të jashtme” ndaj “të brendshme” në determinizmin psikik të sjelljes); (b) vullnetare dhe të ndërmjetësuar nga mendimi (që pasqyron dominancën e të brendshmes mbi të jashtmen), dhe (c) nivelin *mbisituacional* ose të udhëhequr nga sete, vlera, bindje (që pasqyrojnë një balancë harmonike mes të jashtmes dhe të brendshmes).

Studimet e tjera mbi rolin e EI në vendin e punës (7) synuan të ndihmon njerëzit në zotërimin e EI dhe arritjen e shprehjes emocionale në edukimin e tyre në vazhdim (8).

Metoda dhe implementimi

Ky studim është i tipit krahasues, ku përmes metodologjisë mikse, të dhënave studimore metanalitike, modelit Mayor-Slavory dhe koncepteve empirike të mbledhura në kontekst, synohet eksplorimi i operacionalizimit të EI dhe analiza e indeksit të vlerave të implemetuara në arritjet akademike dhe përshtatshmërisë psikologjike përmes testit MCET. Sipas indeksit të pikavarazheve të standardizimit të testit MCET, korrelacioni mes dy gjysmave shumatore konsiderohet si ekuivalent me korrelancën mes dy formave paralele (9). Vlefshmëria mes pikavarazheve është realizuar përmes formulës

$$r_{kk} \frac{2r_{12}}{1 + r_{12}}$$

Andaj, sa më tepër të jetë pikavarazhi pozitiv mes dy gjysmave, aq më i lartë edhe vlefshmëria e kuontit të inteligjencës të marrë.

Subjektet e këtij studimi arrijnë një kampion prej 200 individësh, studentë të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Edukim dhe Institucionit në degën e Psikologjisë.

Subjektet iu nënshtruan vlerësimit të testit MCET, me 20 pyetje në shkallë Likert në vetëvlerësimin në 0-4 (kurrë, shumë, shpesh).


Të dhënat e përmbledhura deskriptive shihen në tabelat dhe grafikët më poshtë:

Tab.1. Mesatarja e pohimeve, kovarianca ndërmjet pohimeve

	Mesatarja	Varianca	Numri i Pohimeve
Mesatarja e pohimeve, kovarianca ndërmjet pohuese	1,574	,621	20
	,669	2,242	20

Tab. 2. Statistikat e Vlefshmërisë

Kronbach Alfa	Cronbach Alfa e bazuar në pohimet e standardizuara MCET	Nr. i pohimeve
0,84	0,83	20

**Fig. 1. Të dhënat e komponentëve në rrotacion Varimax**

Nga indekset e vlerësuara të referuara, është treguar se kovarianca ndërmjet pohimeve është më pozitive ndërmjet tyre, çka na vërteton formulën e formave paralele. Diferenca statistikisht të vlefshme në mesatare u vërejtën mes strukturave të para dhe të dyta në 3/5 e faktorëve, marrëveshjet, ndërgjegjësimin dhe të qenurit i hapur ndaj përvojave të reja ($p < 0.5$ për testet-t) dhe mes strukturave të dyta dhe të treta në katër nga tiparet e personalitetit: introversion, ndërgjegjësim, neuroticizëm dhe të qenurit i hapur ndaj përvojave të reja. Dallimi mes strukturave të para dhe të treta ishin domethënëse në të pestë tiparet e personalitetit.

Elementët e vlerësuar në rrotacionin Varimax përfshijnë përkatësisht: Arritjet Akademike, Përshtajta Psikologjike dhe Dinamikat e Personalitetit. Analiza psikometrike është realizuar përmes programit JMetrik 4.0, një softuer i dedikuar modelit të testit MCET (10).

Gjetjet kryesore

Gjetjet e grumbulluara si në kontekstin e krahasimit metanalitik, ashtu edhe nga administrimi i testit MCET për Inteligjencës Emocionale, tregojnë një lidhje të fuqishme vlefshmërie të Cronbach Alfa =,83. Kovarianca ndërmjet pohimeve dhe komponentëve (=,667) është gjithashtu shumë

inkurajuese në thellimin e kërkimeve të mëtejshme. Vihet re një ngarkesë relative e subjekteve ndërmjet pohimit të 15 dhe të 19, që specifikisht interesohen për aftësitë *coping* në përballimin e stresit.

Të dhënat empirike kanë treguar se tiparet e EI mund të bashkërendohen në një sërë sjelljesh dhe gjykime subjektive. Për të tejkaluar këto inkonsistenca mes tipareve dhe aftësive, kërkuesit linjëzuan disa aftësi si *vetë-efikasiteti emocional* (për elementin dispozitiv) dhe *aftësia emocionale-kognitive* (për elementin e aftësisë) (11).

Autorët kanë argumentuar se “*ekziston një shkallë e aftësisë EI krijuar për të matur se si perceptimi i emocionit do të marrë përgjigje të sakta ose të gabuara, ndërsa tiparet e shkallës të tipareve të EI konsistojnë nga pohimet e vetë-raportimit....*”(7). Hulumtimet e tjera mund të bazohen në një sërë veçorish të EI, të identifikuara nga kërkimet përmes analizës së literaturës së specialistëve dhe profesionistëve përfshirë edhe të dhënat e testit MCET (12).

Hulumtimi i formave të ndryshme të pasqyrit psikik të realitetit mbi nivelet e veprimtarisë sjellore mund të vendosen në aspekte si:

- sensoro-perceptiv;
- të menduarit konceptual ;
- pasqyrimi psikik (niveli më i lartë) që përfshin përvojat sociale të ardhura nga individët.

Kështu që EI mund të përshkruhet lehtë si një faktor sistem-formues në strukturën e personalitetit dhe rritjen e rendimentit *coping*-mbajtës.

Diskutim

Qenia njerëzore përfton në dekursin e veprimtarive jetësore, përkatësitë që nuk janë as totalisht të paracaktuara nga kushtet e jashtme dhe as të trashëguara. Në përshkrimin e formimit të botës së brendshme njerëzore, studiuesit kanë tragetuar tre aspekte që janë të lidhura me operacionalizimin e EI si: aspekti inter-individual; aspekti infra-individual, dhe aspekti meta-individual - karakterizon shkallën në të cilën individ mund të ndikojë njerëzit e tjerë. Studiuesit që kanë studiuar formimin e botës së brendshme së individit, argumentojnë se mekanizmi i formimit të saj shfaqet përmes brendësimit dhe tejashtëzimit të përvojës së përfutur. Procesi i brendësimit interpretohet si formimi i plani të brendshëm për të vënë në jetë veprimtaritë e jashtme, p.sh. përdorimi i proceseve intelektuale. Ky proces vendoset në kursin e brendësimit së formave të jashtme të veprimtarisë dhe shfaqet përsëri në to. Mund të thuhet me bindje se procese të përngjashme krijojnë mekanizmin e formimit të EI: qenia njerëzore brendëson dijen dhe vëzhgimet (si dhe përfitimet e përvojave vetjake) si forma efikase të reagimeve emocionale që promovojnë një përshtatje më të mirë me mjedisin fizik dhe social, si dhe i tejashtëzon ato në formën e veprimeve sjellore korrespondente.

Sipas modelit të rregullimit shumë-nivelor të sjelljes sociale, zgjedhja e formave të ndryshme të sjelljes përcaktohet nga këta faktorë:

1. Vlerat situacionale që përcaktojnë aspektin operacional të sjelljes, që nuk kontrollohet plotësisht nga individ.
2. Norma dhe vlera sociale të fiksuara që përcaktojnë mënyrën e sjelljes, të përsëritur nga individ në situata të përngjashme.
3. Vlera dispozitive që, kur formohen, përcaktojnë linjën e dominimit të sjelljes në sfera të ndryshme të veprimtarisë.

4. Një sistem i vlerave të personalitetit, që përcaktojnë senset e jetës dhe instrumentet e përshtatshme për arritjen e tyre.

Përfundimet

Në përfundim të këtij studimi, do të shtjellonim disa konkluzione kryesore:

1. Në krahasim me format e njohura të Inteligjencës, si Inteligjenca Artificiale, Inteligjenca Emocionale forcon aftësitë *coping* të individit për të rritur rendimentin dhe zvogëlon premisat e ndikimeve negative në shëndet. Zhvillimi i pakushtëzuar i Inteligjencës Artificiale duhet të shoqërohet pashmangshmërisht me zhvillimin e Inteligjencës Emocionale dhe aftësive *coping* (13).
2. Në bazë të të dhënave teorike dhe empirike të analizuar në këtë trajtesë, EI ndërmjetësohet nga bota e brendshme subjektive të personalitetit, përfaqësuar nga karakteristikat *ontologjike* (thelbësore) dhe *fenomologjike* (marrë nga përvoja) dhe nga bota e mjedisit të jashtëm ose virtual (14).
3. Kriteri kryesor për vlerësimin e EI i marrë nga individit duhet hulumtuar te karakteristikat e unitetit dinamik të brendshëm dhe të jashtëm në përcaktimin e sjelljes dhe emocioneve bashkëshoqëruese. Niveli i *ndërmjetëm* i EI karakterizohet nga veprimet e nxitura, të jashtme të performuara në bazë të arsytimit në formën e emocioneve negative. Niveli më i lartë e EI karakterizohet nga niveli më i lartë i zhvillimit të “botës së brendshme” të personalitetit.
4. Hulumtimi i zhvillimit të EI duhet të përkthehet në përpjekje të vazhdueshme të kontekstualizimit të saj në fushën e Psikologjisë dhe të Edukimit. Një nxitje e mirë në këtë aspekt janë të dhënat e mbledhura nga ky ministudim në kontekst, si dhe modeli i propozuar nga kërkimet inovative mbi zhvillimin e EI në varësi të kurrikulës (15).

Referencat

1. Mayer, J. D., Salovey, P., dhe Caruso, D. “*Models of emotional intelligence*”. Në R. J. Sternberg (Bot.), *The handbook of intelligence* fq. 396–420. New York: Cambridge University Press, 2000
2. Davies, M., Stankov, L., dhe Roberts, R. D., “*Emotional intelligence: in search of an elusive construct*”. *Journal of Personality and Social Psychology* 75: fq. 989–1015, 1998
3. Mayer, J. D., Salovey, P., Caruso, D. R., dhe Sitarenios, G. . “*Measuring emotional intelligence with the MSCEIT V2.0. Emotion*”, 3, fq. 97–105, 2003
4. McCrae, R. R. “*Emotional intelligence from the perspective of the five-factor model of personality*”. Në R. Bar-O dhe J. D. A. Parker (Bot.), *Handbook of emotional intelligence*, San Francisco: Jossey-Bass, fq. 263–276, 2000
5. Brody, N . “*Emotional intelligence: Science and myth*” (shqyrtim nga libri). *Personality and Individual Differences*, 32, fq. 109–111, 2004
6. Fan, X. dhe Furnham, J. “*Two approaches for correcting correlation attenuation caused by measurement error: Implications for research practice*”. *Educational and Psychological Measurement*, 63, fq. 915–930, 2001
7. Goleman, D. “*Emotional Intelligence*”. New York: Bantam Books, fq. 428, 1995
8. Jimerson, S., Egeland, B., Sroufe, L. A., dhe Carlson, B. “*A prospective longitudinal study of high school dropouts examining multiple predictors across development*”. *Journal of School Psychology*, 8, fq. 525–549, 2000
9. Gignac, G. E. “*Working memory and fluid intelligence are both identical :Reanalyses and critical evaluation*”. *Psychological Science*, 49, fq. 187–207, 2007

10. Cooper, R. K. dhe Sawaf, A. “ *Executive EQ: Emotional Intelligence in Leadership and Organizations*”. Grosset Putnum: New York, 1997
11. Hein, S. “*EQ for Everybody: A Practical Guide to Emotional Intelligence*”. Gainseville, FL: Alligator, 1997
12. Thompson, B., dhe Vacha-Haase, T. “*Psychometrics and datametrics: The test is not reliable*”. Educational and Psychological Measurement, 60, fq. 174–195, 2000.
13. Borsboom, D. “*Measuring the mind: Conceptual issues in contemporary psychometrics*”. Cambridge: Cambridge University Press, 2005.
14. Stough, C., Saklofske, H. Donald dhe Parker dhe D. A. James “*Assessing Emotional Intelligence, Theory, Research and Applications*”, Springer, NY, 2008
15. Matthews, G., Zeidner, M. dhe Roberts, R. D. “*Emotional intelligence: Science and myth*”. Cambridge, MA: MIT Press, 2002